



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

V E N D I M

NR. 61, DATË 30 / 12 / 2016

PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2017

NË BASHKINË VAU DEJËS

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës i mbledhur me datën 30 / 12 2016, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Sektori i të Ardhurave, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2017”, mbështetur në nenin 35, pika 1, germa a,b,c,dh,e dhe pika 2,3,4,5, germa a,b,c,ç, nenit 36 pika 1 dhe 2, nenit 54 germa “f”, nenit 55 pika 3 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”; Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për shërbimin vetrinar në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “ Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, ” Për fondin kullosor” i ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice votash:



VENDOSI

1. Miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vau Dejës për vitin 2017.
2. Këtij vendimi i bashkëngjitet paketa fiskale me tabelat përkatëse.
3. Ngarkohet për zbatim Sektori i të Ardhurave.
4. Ky vendim u shpall sot me datë 11 / 01 2017.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015.

SEKRETARI I KESHILLIT

Gentian NDOJ



KRYETARI I KËSHILLIT

Martin MARKU